

Rima Hoxha

Vajza dhe Njëbrirëshi



VAJZA DHE NJËBRIRËSHI

A decorative background featuring a soft, wavy pink gradient that flows from the bottom left towards the top right. Scattered throughout this gradient are numerous small, bright pink and white sparkles, giving the impression of a magical or ethereal atmosphere.

Autor:

Rima Hoxha &

Familja Hoxha

Ilustrimet:

Dalle, ChatGPT

Prishtinë, 2025

Copyright © Rima Hoxha



*Ky libër i dedikohet shoqeve dhe
shokëve të klasës sime, nxënësve të
klasës II-3 të shkollës fillore “Mileniumi i
Tretë” në Prishtinë.*

*Libri është një histori pak a shumë
personale, e ndërthurur me elemente
magjike dhe e shkruar në formën e një
përralle.*

Lexim të këndshëm!

Rima Hoxha

Na ishte njëherë një vajzë e vogël me emrin Aria. Ajo ishte e magjepsur pas njëbrireshave dhe fliste vazhdimisht për ta. Kur shokët dhe shoqet e saj të klasës thoshin se nuk besonin në ekzistencën e tyre, Aria ndjente se ata thjesht nuk e kuptonin magjinë. Sa herë që luante me lodrat e saj njëbrireshe, ajo ndjente thellë në zemër se një ditë do të takonte një njëbriresh të vërtetë.



Një natë vere, ndërsa frynte një erë e lehtë dhe qielli ishte plot yje, Aria dëgjoji një tingull të butë jashtë dritares së dhomës së saj. Me zemrën që i rrihte fort, ajo iu afrua ngadalë dritares dhe... aty, nën shkëlqimin e qetë të hënës, qëndronte një njëbrirësh i bardhë mahnitës, me një bri të artë që rrezatonte një dritë të butë magjike.



— Kush je ti? — pyeti Aria me habi.

— Unë jam Lola, njëbrirëshi yt. Kam ardhur të të shfaqem, sepse çdo natë dëgjoja dëshirën tënde për të më takuar. Ti ke besuar tek unë me gjithë zemër, dhe kjo është e rëndësishme. Ne i shohim fëmijët si ti dhe i ndihmojmë sa herë kanë nevojë. Por mbaje mend: vetëm ata që kanë një zemër të pastër mund të na shohin — ashtu siç po më sheh ti tani.



Njëbrirëshi Lola fluturoi dhe përmes dritares së hapur, hyri në dhomën e Arijës. Ato u përqaftuan me shumë dashuri, si dy muke të vjetra që më në fund takohen. Më pas, Lola e mori Ariën mbi shpinë dhe bashkë fluturuan mbi qytet, duke kaluar përmes reve të argjendta ku yjet ndriçonin si thesarë në qiell. Gjatë udhëtimit, Lola i tregoi Arijës se çdo yll mbante brenda vetes një ëndërr të një fëmije — një dëshirë që priste të ndriçonte.



Pasi udhëtuan gjithë natën mes yjeve dhe galaktikave të largëta, Lola i tha se ishte koha të ktheheshin në shtëpi.

— Pse duhet të kthehemi? — pyeti Aria me një zë të butë, plot mall. — Unë dua të vazhdojmë të fluturojmë bashkë... të shijojmë edhe pak më shumë këtë magji.



— Është koha të kthehemi në shtëpi — tha njëbrirëshja Lola. Më pas shtoi:

— Së shpejti do të agojë dita dhe ti do të nisesh për në shkollë, ndërsa unë do të rikthehem në botën time, atje ku sytë tuaj nuk mund të më shohin.



Njëbrirëshi Lola e preku ballin e Ariës me briun e saj, dhe një dritë magjike hyri brenda saj.

— Sa herë që do të më kujtosh, unë do të jem pranë teje — i pëshpëriti Lola. — Kur të ndihesh e trishtuar apo e pafuqishme, mendo për prekjen e këtij briu dhe dritën që të dhurova — ajo do të të japë forcë. Unë do të jem gjithmonë afër teje, duke të mbrojtur në heshtje.



Që nga ajo ditë, Aria e mbante gjithmonë brenda zemrës dritën magjike të njëbrirëshit të saj. Ajo luante e qeshte me shokët dhe shoqet, dhe sa herë mendonte për Lolën, ndihej e lumtur me gjithë shpirt. E çdo natë, kur shtrihej për të fjetur, ajo e ndiente se njëbrirëshi Lola gjithmonë i pëshpëriste: “Jam ende me ty.”



Vajza dhe Njëbrirëshi

